



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 1 (827907)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 10 janar 2025

Mbrojtja 2024 drejt sfidave 2025



E Ngarkuara me Punë në Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, zonja Nancy VanHorn, zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralletënant Arben Kingji.

Në këtë takim, zonja VanHorn shoqërohej nga Atasheu Amerikan në Tiranë, kapiten i rangut të dytë Eric Cote, oficerja për çështjet politike dhe ushtarake në Ambasadën Amerikane, zonja Nisha Abraham, dhe shefi i ODC, major Joshua Magnusson.

Gjeneralletënant Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen zonjës VanHorn dhe ekipit që e shoqëronte, vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe në fushën e mbrojtjes dhe mbështetjen e pakursyer të SHBA-ve për reformimin, transformimin, dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura.

Në vijim, ai i njohu me disa nga zhvillimet kryesore në Forcat e Armatosura, rishikimin e dokumenteve strategjike, përmirësimet strukturore dhe ligjore, ecurinë e projekteve të modernizimit, zhvillimin e infrastrukturës ushtarake, kontributin në misionet dhe operacione, masat e marra në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes dhe planeve rajonale, etj.

Gjatë takimit, një vëmendje e veçantë iu kushtua dinamikave në mjedisin e sigurisë në zonën Euroatlantike dhe sidomos në Ballkanin Perëndimor, zhvillimit të koncepteve të shkurajimit dhe mbrojtjes, dhe masave të marra nga vendi ynë në kuadër të rishikimit të planeve kombëtare të mbrojtjes dhe harmonizimit me planet rajonale të Aleancës.

Në lidhje me situatën e sigurisë në rajon, gjeneralletënant Kingji vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të misionit KFOR dhe EUFOR për sigurinë dhe stabilitetin rajonal, prezencën dhe angazhimin e SHBA-ve në këtë drejtim, si dhe vendimin e palës shqiptare për të rritur kontributin në EUFOR me një togë këmbësorie në ditët në vijim.



SHSHP, gjeneralletënant Arben Kingji priti zëvendësshefen e Misionit dhe të Ngarkuarën me Punë në Ambasadën e SHBA-ve, zonjën Nancy VanHorn

Po kështu, gjeneralletënant Kingji theksoi rolin e vendit tonë për stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal, përpjekje këto të shtyra më tej gjatë vitit që shkoi nëpërmjet kryesimit nga vendi ynë të iniciativave të Shefave të Shtabit

të Ballkanit (BCHODs) dhe SHBA – Karta e Adriatikut, si një mënyrë e mirë për të nxitur stabilitetin dhe sigurinë në rajon nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak.

Zonja VanHorn vlerësoi bashkëpunimin

tonë dypalësh dhe shprehu angazhimin e saj për zhvillimin e tij në të ardhmen, theksoi rolin e vendit tonë për stabilitetin rajonal dhe kontributin cilësor dhe domethënës të FARSH-së në misionet dhe operacionet jashtë vendit.





Mbrojtja 2024 drejt sfidave 2025

Ministria e Mbrojtjes në misionin e saj për zhvillimin perspektiv të FA-së, të politikave dhe direktivave të Këshillit të Ministrave në fushën e mbrojtjes, në fushën sociale, në atë të integritimit, zhvillimit e modernizimit të FA-së, në përputhje me standardet e NATO-s; për vitin 2024 arriti të realizojë disa prej objektivave të saj si: Shtesë të trajtim financiar ku rreth 6000 efektivë të FA-së, prej të cilëve 2500 efektivë e marrin atë për herë të parë. Trajtim më të mirë financiar do të përfitojnë edhe kapacitete kombëtare si: Forcat Speciale, pilotët, inxhinierët dhe teknikët e mirëmbajtjes, njësia cyber, dronët, forcat e dedikuara për emergjencat civile etj.

Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit rezervist në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin.

Ligji funksionon si pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, dhe do të shërbejë për të siguruar individë të trajnuar, me qëllim kompletimin e strukturës së FA-së, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar si dhe rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në kontekstin aktual të sigurisë në rajon e më gjerë si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacioneve në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes, sigurisë rajonale e globale si dhe operacionet e emergjencave civile.

Shërbimi në rezervë do të përfshijë një forcë rezerviste që do të përbëhet nga 25% e forcave aktive, ose rreth 2100 personel, duke siguruar kështu një kapacitet të rëndësishëm për reagim të shpejtë në raste emergjente. Sipas përcaktimeve të ligjit të ri, ushtarakët, të cilët në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë dalë në rezervë, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si edhe shtetasit civilë, të cilët plotësojnë kriteret e pranimit të shërbimit ushtarak në rezervë, rekrutohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit dhe nënshkruajnë kontratën përkatëse për shërbimin ushtarak në rezervë me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë. Ushtarakët në rezervë gëzojnë të gjitha të drejtat si ushtarakët aktivë, ndërsa i jepet grada ushtarake që ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura. Shtetasit shqiptarë që nuk kanë shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë kriteret e pranimit në shërbimin ushtarak në rezervë titullohen dhe u jepet grada e parë ushtarake.

Miratimi i ligjit “Për shërbimin e kërkim - shpëtimit”, ku Shqipëria ka detyrim të ofrojë shërbim të besueshëm dhe efikas. Ky ligj ka si qëllim funksionimin e një shërbimi efikas dhe bashkëkohor të kërkim - shpëtimit, duke rregulluar fushën e përgjegjësisë së këtij shërbimi, si dhe duke iu përgjigjur nevojave aktuale për rristurimin e këtij shërbimi në respektim të përcaktimeve të detyrimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Ky ligj është një hap thelbësor, qoftë nga



pikëpamja e linjësimit me standardet ndërkombëtare, qoftë nga pikëpamja e rritjes së kapaciteteve të shërbimit të kërkim - shpëtimit në vendin tonë.

Buxheti 2025, një buxhet historik, i cili shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe të sigurisë kombëtare, buxheti i sektorit të Mbrojtjes parashikon një total prej 52,7 miliard lekësh, që përbën një rritje prej 4,6% krahasuar me vitin 2024. Shpenzimet e Mbrojtjes rriten nga 215\$ për frymë, në 219\$ për frymë në vitin 2025.

“Për vitin e dytë radhazi, Buxheti i Mbrojtjes mbetet mbi kufirin 2% të PBB, ndërkohë që mbi 20% e totalit të shpenzimeve i dedikohen investimeve në pajisje kritike dhe modernizim”, - u shpreh ministri Vengu. Sipas tij, për vitin që vjen totali i shpenzimeve kapitale vjen në rritje: “Kemi një vlerë prej 28,2 miliardë lekë, ku shpenzimet kapitale me financim të huaj janë në masën 12,2 miliardë lekë”, - tha ministri i Mbrojtjes.

Një nga prioritetet kryesore të këtij buxheti është rritja e pagave për personelin ushtarak: “Është parashikuar një rritje domethënëse mbi pagë, nga e cila përfitojnë rreth 6 mijë ushtarakë, ku rrishtas

përfitojnë rreth 2500 prej tyre. Rritja e vijueshme e pagave e çon në fakt në 71% rritjen që nga viti 2021. Pra përpjekja e madhe buxhetore që i kërkojmë taksapaguesit shqiptar i dedikohet pikë së pari trajtimit dinjitoz të personelit ushtarak.

Ky është një hap domethënës drejt arritjes së objektivit të qeverisë shqiptare për një trupë ushtarake të mirë pajisur, të mirë paguar dhe të mirë stërvitur. Synimi është që deri në vitin 2030, ky komponent të përbëjë rreth 1/5 e Forcave të

tonë, një proces tashmë i nisur, i cili do të kthejë aftësitë zhvilluese dhe prodhuese, të municioneve, lëndëve plasëse dhe armatimit të lehtë, mbështetur në teknologjinë më të avancuar për prodhimin e tyre, për ta kthyer këtë industri në nivele konkurruese edhe për tregjet ndërkombëtare, është një tjetër pikë e këtij buxheti. Rivitalizimi i Industrisë Ushtarake, do të sjellë gjenerimin e të ardhurave brenda vitit 2025.

Gjatë vitit 2024, FA-të kanë realizuar një



Armatosura ose në shifra, 2100 forca.

Modernizimi dhe rritja e gatishmërisë operacionale, zë vendin më të madh të burimeve financiare me një peshë specifike prej 54,8% e Buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2025. Ky buxhet siguron vijimësinë e 21 projekteve të modernizimit, që janë në zbatim e sipër dhe fillimin e 8 projekteve të reja në sisteme mbrojtëse për rritjen e reagimit të shpejtë të Forcave të Armatosura.

Një vëmendje është edhe pjesa e emergjencave civile që në këtë buxhet, sipas ministrit Vengu janë në vlerën 5,5 miliardë lekë, duke njohur rritjen më të konsiderueshme të viteve të fundit.

Ringritja e Industrisë Ushtarake në vendin

sërë trajnimesh, stërvitje të përbashkëta me forca aleate dhe partnere, ndërsa kanë vijuar përpjekjet për modernizimin e saj, me qëllim përgatitjen për përballimin e kërcënimeve të mundshme.

Prioritet kryesor ka qenë edhe këtë vit forcimi i bashkëpunimit me NATO-n.

Pjesëmarrja në misionet ndërkombëtare dhe trajnimit me aleatët ka kontribuar në rritjen e aftësive profesionale të efektivëve shqiptarë.

Pjesë e aktiviteteve të FA-së ka qenë gjatë këtij viti edhe ndihma ndaj komunitetit në rastet e emergjencave natyrore.

Ministria e Mbrojtjes ka angazhuar gjithashtu burime për të mbështetur zhvillimin profesional dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit të saj.



Komanda Mbështetëse e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë e ka nisur vitin 2025 në mjedise tërësisht të transformuara në infrastrukturë dhe me drejtues të ri.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu ishte i pranishëm në prezantimin e komandantit të ri të Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, në këto mjedise të reja.

Pjesë e kësaj ceremonie ishin gjithashtu shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, efektivë të Komandës Mbështetëse dhe Forcave të Armatosura.

Ministri Vengu, u shpreh besimplotë se, gjeneral Aleksandër Pando është njeriu i duhur për ta çuar përpara këtë Komandë kaq të rëndësishme në rrugën e saj drejt modernizimit dhe rritjes së efikasitetit.

Vengu theksoi se: “Kjo Komandë, si një nga pjesët më të rëndësishme të zinxhirit funksional të Forcave të Armatosura, do të vazhdojë të zhvillohet dhe të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve tona dhe në ruajtjen e paqes në rajon, por edhe në misionin e saj fisnik për t’u dalë në krah dhe ndihmuar civilët në raste emergjencash”.

“Si ministër i Mbrojtjes, jam tërësisht i angazhuar në mbështetje të plotë të të gjithë komponentëve të Forcave tona, duke garantuar që ata të jenë të përgatitur dhe të gatshëm për të përballuar çdo sfidë”, nënvizoi Vengu.

Gjeneral brigade Pando ka shërbyer më herët si drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Komanda Mbështetëse është një strukturë mjaft e rëndësishme e Forcave të Armatosura, që ka si qëllim të saj, sigurimin e kapaciteteve për mbështetjen me logjistikë, infrastrukturë, shërbim shëndetësor dhe shërbime të tjera të FA-së në interes të plotësimit të misionit të tyre kushtetues.

Pas mjediseve të reja, në të cilat do të operojë Komanda Mbështetëse, synimi i Ministrisë së Mbrojtjes është që të zgjerojë kapacitetet e saj dhe të vijojë procesin modernizues për rritjen e efikasitetit dhe forcimin e saj, edhe si një nyjë jetike e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Komanda Mbështetëse nisi 2025-ën me mjedise të transformuara dhe drejtues të ri



Operacioni SAR, vazhdon misioni në Detin Egje



Efektivët e Anijes “Oriku” P132, në bashkëpunim me Rojën Bregdetare të Turqisë dhe Greqisë, realizuan një operacion shpëtimi (SAR) duke i ardhur në ndihmë një gomoneje me 30 emigrantë nga Palestina dhe Afganistani.

Pas përfundimit me sukses të operacionit, emigrantët u morën nën kujdes nga Roja Bregdetare Turke. Ky është misioni i dytë brenda dy javëve që “Oriku” me mision në Detin Egje, ndihmon në operacionet e shpëtimit.



FLOTILJA USHTARAKE

në rrugëtimin e saj, 61 vjet lundrim mbi ujërat shqiptare

Nga fundi i vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe vendosi ristrukturimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim Ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotilja e Durrësit dhe Flotilja e Vlorës.

Si kriter bazë i caktimit të kuadrove do të merrej vendbanimi Durrës, dhe kjo për efekte strehimi. Në përbërje të Flotiljes Durrës u caktuan anije minaheqëse, gjuajtëse kundër ND si dhe anije ndihmuese. Komandant ishte caktuar Dashamir Ohri. Ai vinte nga një përvojë e pasur si ish-komandanti i bazës së nëndetësve të Pashalimanit, pikërisht në periudhën kur ishte krijuar konflikti i madh me aleatin e atëhershëm, Bashkimin Sovjetik. Ai është dhe një nga 17 oficerët e parë shqiptarë që ka mbaruar studimet në vitin 1947 në ish-Jugosllavi. Është, ndërkohë edhe një nga specialistët e parë të përgatitur në ish-Bashkimin Sovjetik dhe më pas, një ndër personat e parë, i përgatitur për nëndetëse po në ish-Bashkimin Sovjetik. Dashamir Ohri ka qenë pikërisht komandanti i nëndetësës së parë shqiptare, të ardhur me një katërshe nga Bashkimi Sovjetik.

Në mesditën e 4 janarit 1965, kap. rangut III Dashamir Ohri, i emëruar komandant i Flotiljes Durrës, organizon një takim me kuadrot e Shtabit të Flotiljes dhe komandantët e anijeve, i njeh me planin e lundrimit të Flotiljes nga Sazani në Durrës. Rreth orës 20:00 fillon dalja e anijeve nga Sazani.

Dalja e anijeve u shoqërua me rënien e sirenavë si përshëndetje tradicionale e FLD-së. Lundrimi për në Durrës u bë natën, në formacion lundrimi dhe në kushtet e një deti të trazuar. Në mëngjesin e datës 05 janar 1965, anijet mbërritën në Radin e Durrësit, e më pas u akostuan në Kalatën Lindore të Portit Detar Durrës.

Kështu data 5 janar 1965, shënon ditën e rikrijimit të Bazës Detare Durrës. Para komandës e shtabit të Flotiljes dilnin detyra për konsolidimin e vendbazimit. Nisi gjithçka nga e para, sepse mungonte infrastruktura, si bankinat, godina e komandës, kushtet e përgatitjes speciale, depot, baza materiale për përgatitjen e efektivave etj. Në sajë të punës vetëmohuese të kuadrove dhe efektivave u arrit që të ndërtohej bankina e silurë-hedhësve, ofiçina



RRUGA NË TË CILËN KA ECUR BAZA DETARE E DURRËSIT GJATË KËTYRE VITEVE ËSHTË E MBUSHUR ME SAKRIFICA NË KRYERJEN E DETYRAVE PËR MBROJTJEN E UJËRAVE TONA TERRITORIALE NGA VEPRIMTARITË E PALIGJSHME TË ANIJEVE TË HUAJA, NDALIMIN E TENTATIVAVE PËR KONTRABANDË ETJ. NË VITE, BAZËS IU SHTUAN ANIJE TË TJERA SI SILURË-HEDHËSE, GJUAJTËS DETAR, U NDËRTUAN VENDBAZIMI NË B. PALLË, OFIÇINA TË RIPARIMIT TË ANIJEVE, GODINAT E KOMANDËS, SHKOLLA E PËRGATITJES SË EFEKTIVAVE ETJ.

e silurëve si domosdoshmëri për anijet që pritej të vinin në vitin 1965 nga RP e Kinës. Ndhmesë të madhe për sigurimin e kushteve të vendbazimit dhanë edhe ndërmarrjet e qytetit të Durrësit si NN Porti, Porti Detar etj.

Rruga në të cilën ka ecur Baza Detare e Durrësit gjatë këtyre viteve është e mbushur me sakrifica në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e ujërave tona territoriale nga veprimtaritë e paligjshme të anijeve të huaja, ndalimin e tentativave për kontrabandë etj.

Në vite, Bazës iu shtuan anije të tjera si silurë-hedhëse, gjuajtës detar, u ndërtuan vendbazimi në B. Pallë, ofiçina të riparimit të anijeve, godinat e komandës, shkolla e përgatitjes së efektivave etj.

Janë të shumtë ish-detarët që kanë kryer shërbimin ushtarak në Bazën e Durrësit që punojnë në profesione të ndryshme në Flotën Tregtare, në Flotën e Peshkimit etj. Në këtë 59-vjetor të rikrijimit të Bazës Detare të Durrësit, për punën plot përkushtim në shërbim të atdheut kujtojmë me nderim e respekt kuadrot e

para që hodhën themelet e krijimit dhe konsolidimit të Bazës, të cilët janë ndarë nga jeta, si: komandantët e Bazës në vite kap. i rangut III D. Ohri, kap. i rangut I M. Plani, shefi i Shtabit të Bazës, kap. i rangut III M. Lulolli, komandantët e skuadriljeve silurë-hedhëse, kap. i rangut III Selam Qejvani, kap. i rangut III Ali Canosinaj, komandantin e grupit të anijeve mbiujëse Petro Treni, Ing. mekanikët Piro Tushi, Ismet Beluli, Sami Shyti, Mark Berdufi, M. Hysi; kuadrot me përvojë Xh. Bujari, Vasil Petro, Spiro Kote, A. Sevrani, B. Demko, Mihallaq Papadhopulli, B. Shehu, T. Gërveni, Skënder Sulku, Halit Hima, Thoma Rubia, B. Kelmendi, S. Beluli, I. Rexha etj., si dhe Tasim Sinani, Hektor Meçe, A. Daja, D. Hoxha, që u larguan nga jeta shumë para kohe.

Përveç vështirësive që lindën nga ridislokimi, zgjerimi i forcave detare në përmasa të tilla, nuk mund të përballohej me efektivat që kishte, veçanërisht me kuadro. Edhe pse qeveria shqiptare i kishte paraprirë këtij zgjerimi, duke dërguar disa vite më parë studentë



ME NDRYSHIMIN E SISTEMIT POLITIK NË VITIN 1990, BAZA DETARE E DURRËSIT PËSOI NDRYSHIMET E VETA NË KONCEPTIN E DETYRAVE, ORGANIZIM DHE STRUKTURË. SI REZULTAT I HAPJES ME BOTËN, NË UJËRAT TONA U RRIIT INTENSITETI I LËVIZJEVE TË ANIJEVE TË HUAJA PËR QËLLIME EKONOMIKE, TURISTIKE E KONTRABANDE. PËR RRJEDHOJË U RRIIT EDHE MUNDËSIA E SHKELJEVE TË UJËRAVE TONA U SHTUA VEPRIMTARIA PËR PESHKIM TË PALIGJSHËM, PËRPJEKJA PËR TRAFIQE TË KLANDESTINËVE, TË DROGËS, TË ARMËVE ETJ.

në akademitë e BS, ndër ta kishte grupe studentësh që ende nuk i kishin përfunduar studimet. Prandaj lindi nevoja e kalimit në forcat detare të shumë kuadrove nga repartet e artillerisë kundërajrore dhe bregdetare të ushtrisë. Ndërkohë, pranë shkollës së specialiteteve u ngrit një kurs 9-mujor me detarë që kishin mbaruar shkollën e mesme dhe që kishin aftësitë e duhura për t'i titulluar oficerë.

Pra, viti 1958 mund të quhet viti i një ndryshimi të madh në forcat detare shqiptare. Ato përfaqësoheshin në MMP nga kapiten i rangut I Abdi Mati dhe kishin këtë strukturë, Komanda dhe shtabi i FLD-së – komandant – kapiten i rangut I Teme Sejko – shef i degës politike, kolonel Hajdar Aranitasi – komandant prapavije, kolonel Bedri Gjergji – shef shtabi, kapiten i rangut II Mark Plani dhe anëtarë shtabi kapiten-lejtnant II Sezai Osmani, kapiten-lejtnant II Seit Jonuzaj, kapiten II Xhemali Milori, kapiten I Perlat Molla, kapiten-lejtnant II Qemal Hysaj, kapiten-lejtnant II inxhinier Tahir Hoxha etj.; Brigada e Nëndetësve (Br. ND), me vendbazim në Pashaliman, Brigada e Mbrojtjes së Rajonit të Ujërave (Br. MRU), me vendbazim në Sazan, ku përfshihehin: grupi i gjuajtësve detarë (GJD), me katër gjuajtës detarë; grupi i minaheqësve (MH), me dy minaheqëse të vogla, grupi i moto silurueseve (MS), me gjashtë moto siluruese tip 123-biz, detashmenti i anijeve ndihmëse (DAN) në varësi të komandës së prapavijës së Flotës në Vlorë, shkolla e specialiteteve (e transferuar nga Durrësi në Pashaliman), rajoni i pikave sinjal-vrojtuese (PSV) pranë komandës së Flotës në Vlorë, shërbimi hidrografik me qendër në Ujë të Ftohtë (tek “Shtatë Pallatet”). Pas dy vjetësh pune intensive nga komanda, shtabi, gjithë repartet e Flotës, xhenios së ushtrisë si dhe, falë mbështetjes së qeverisë, në mesin e vitit 1958 përfundoi ndërtimi

i bazës së Pashalimanit, rikonstruksioni i bazës së Sazanit si dhe kompletimi i reparteve të Flotës. Për të festuar rezultatet e arritura në zhvillimin e modernizimin e forcave detare si dhe për t'ia bërë ato të njohura popullit, u vendos që me rastin e përvjetorit të Ushtrisë Popullore të zhvillohej në gjirin e Vlorës një paradë detare.

Për punën e mirë në riorganizimin dhe kompletimin e forcave detare, shefi i seksionit të Marinës, pranë MMP Abdi Mati dhe komandanti i Flotës Teme Sejko u graduan kundëradmiralë, ndërsa shumë kuadro të tjerë u graduan jashtë radhe si dhe u bënë dekorime. Gjithashtu, për t'iu përgjigjur nivelit të zhvillimit të forcave detare shumë kuadro e detarë u dërguan për specializim në BS. Në vijim, efektivat e flotës intensifikuan stërvitjet në bazë dhe në det. Në verën e vitit 1959 edhe efektivat e katër nëndetësve i kishin realizuar objektivat për marrjen në dorëzim të tyre, ndërkohë që nga anijet mbiujëse specialistët sovjetikë ishin larguar. Prandaj nga MMP u vu detyrë përgatitja dhe zhvillimi i një stërvitjeje me qëllim përpunimin e bashkëveprimit të llojeve të ndryshme të armëve të ushtrisë në bregdet, në kushtet e një zbarkimi të mundshëm armik nga deti. Për zhvillimin e saj u caktua si vend rajoni i gjirit të Drinit. Pasi u bënë të gjitha përgatitjet e nevojshme, në shkurt 1961 u vendos fillimi i stërvitjes së koduar Drini-61, ku, nën drejtimin e komandantit të FLD-së Hito Çako, morën pjesë: Brigada e nëndetësve shqiptare dhe nëndetëset sovjetike të dislokuara në gjirin e Vlorës; Brigada e MRU (tetë minaheqëse, katër gjuajtës detarë, cisterna e naftës Patosi, anija silurëkapëse dhe gjashtë motosiluruese) si dhe detashmenti i anijeve ndihmëse; Artileria Bregdetare Durrës-Rodon-Shëngjin; Repartet bregdetare të këmbësorisë të rajonit Durrës-Shëngjin dhe Aviacioni

Ushtarak Shqiptar. Në stërvitje morën pjesë komanda dhe shtabi i FLD-së, përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm e Ministria e Mbrojtjes, ndërsa nga pala sovjetike një grup këshilltarësh (si vëzhgues) nën drejtimin e kundëradmiralit Kulik, të gjithë të vendosur në Bazën Lundruese Tomori. Stërvitja zgjati 10 ditë dhe u zhvillua në kushtet e një moti të keq, mbi mesataren, por kjo gjë nuk ndikoi në realizimin e planit. Nga fundi i vitit 1964 Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe vendosi ristrukturimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim Ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotila e Durrësit dhe Flotila e Vlorës. Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona, u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafike të klandestinëve, të drogës, të armëve etj. Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tanë kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknikë bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale. Me ndryshimin e sistemit politik në vitin 1990, Baza detare e Durrësit pësoi ndryshimet e veta në konceptin e detyrave, organizim dhe strukturë. Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafike të klandestinëve, të drogës, të armëve etj.

Baza Detare e Durrësit i ka përballuar të gjitha detyrat në ndalimin e këtyre veprimtarive të paligjshme. Në këtë aspekt kontribut ka dhënë edhe bashkëveprimi me anijet e Flotave Ushtarakë të NATO-s. Vlen të përmenden veprimtaritë e përbashkëta të mjeteve të Bazës Detare të Durrësit, duke ndaluar misione kontrabande, anije naftëmbajtëse etj. Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknikë bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.

Tasim Meçe, komandant dhe personalitet i detarisë shqiptare



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Të flasësh për komandantët e detit, ata që bënin “zap” edhe shtrëngatat e detit nuk është e thjeshtë. Ata janë si një gjësim i thellë deti dhe zemra e tyre është e lidhur përjetësisht me të. Detarët e Marinës Luftarake Detare si komandant Tasim Meçe gjithë qenien e tyre shpirtërore e kanë trupëzuar me atë masë gjigande uji, që miqësinë e kanë vetëm me ata që dinë të sillen dhe ta trajtojnë detin si shtëpinë e tyre. Komandantët e detit ia njohin huqet detit, e dinë dhe e duan fort detin, sepse jetën e kanë lidhur përjetësisht me të.

Hallet dhe dertet i kanë pazgjidhshmërisht me uturimën e valëve të detit, ata që zhyten me trup e shpirt dhe dinë të dalin dhe t’ia dalin një prej zanateve më të vjetra të njerëzimit, atë të detarit, që tokën e kanë përkohshmëri dhe detin e kanë në shpirt, por edhe shpirtin e zemrën e kanë sa deti. Anijet luftarake që drejtuan ishin dhe ngelën jo vetëm kujtime, por një jetë e gjallë në kaltërsitë e detit Jon dhe Adriatik, në përmbushje të misionit të paprekshmërisë së kufijve detarë shqiptarë.

Rrënjët familjare të Tasim Bido Meçe, i lindur në Rusan të Delvinës

Familja e Tasim Meçes, sikurse gjithë shqiptarët, kishin jetuar shekujve me një shpirt të lirë dhe që nuk e duronin dot shtypjen e shfrytëzimin, i urrenin pushtimet e perandorive që shkelën e shtypën lirinë e shqiptarëve në të gjitha epokat. Fisi i oxhakut familjar “Meçe” është me prejardhje nga Mavrova e Vlorës, që kishte zbaritur në Delvinë që rreth shekullit të XVIII. Por fakt është se stërgjyshi (Jaho) dhe gjyshi (Hysni) i Tasim Meçes kanë lindur në Delvinë. I pari që ka mbërritur në Delvinë nga Mavrova ka qenë Muhamet meçe (pra para 5 brezash). Tasimi është brezi i pestë i familjes Meçe. Babai i tij, Bido Meçe me profesion bujk, fshatar i mesëm, nëna Sadika Meçe shtëpiake, vajzë nga Mazo Bazaiti nga lagjia “Xhermëhallë”, ose lagjia “Lala Malo” (e motra e Javer Malos) dhe mbesë në Zejnataj në Lagjen Kasapaj. Gjyshja nga babai i Tasimit ka qenë nga Xhermëhalla, kushërirë e parë me dëshmoren Lala Malo. Familja Meçe ka qenë e lidhur ngushtë me LANÇ-in, edhe pse babai i tij nuk ka marrë pjesë me armë në dorë në luftë, por ka ndihmuar formacionet luftarake partizane. Në vitin 1946 në shtëpinë tonë është krijuar Këshilli Nacionalçlirimtar i fshatit dhe kryetar këshilli u emërua Bido Meçe. Vëllai i tij më i madh Qemal Meçe para çlirimit ishte kryeplak i fshatit dhe pas çlirimit shkoi në Tiranë, ku është marrë me tregti. Xhaxhai tjetër Hamdi Meçe së bashku me dajon tim, Galip Bazaiti ishin partizanë të Br19S, që ishte krijuar në Theollogo të Sarandës, më 30 gusht 1944. Që të dy kanë shkuar me luftime deri në Vishegrad në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë dhe të dy kanë qenë invalid të luftës nacionalçlirimtare. Një nip i babait të Tasim Meçes, Kabo Kabi nga Borshi është dëshmor i luftës, i cili ka rënë në Libohovë. Babai i tij Xhevat Kabo ka qenë shoqërues i parë i Ismail Qemalit, themeluesit të shtetit modern shqiptar më 28.11.1912.

Tasim Bido Meçe është lindur në Rusan të Delvinës, më 14 maj 1940, në një ambient atdhetar e patriotik, nga prindër të nderuar dhe të respektuar jo vetëm në Rusan por në mbarë trevën përreth Delvinës. Shkollën fillore e kreu në Gizdarat, ndërsa 7-vjeçaren në shkollën “10 Korriku” në Delvinë dhe e përfundoi në vitin 1953. Në vitin 1954 shkon për studime në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, të cilën e përfundoi në vitin 1958 me rezultate shumë të mira. Për këtë arsye në shtator 1958 u përzgjedh dhe u dërgua për studime në ish-Bashkimin Sovjetik, në Shkollën e Lartë të Detarisë në Baku, Azerbajxhan. Meqenëse më 17 shtator 1958, u krijua Brigada e Nëndetëseve në Pashaliman dhe duheshin kuadro për Nëndetëse, për këtë arsye 12 studentë të vitit të parë u përzgjedhën për të shërbyer në Nëndetëse. Pas 6 muajsh shkollë në Baku transferohen në Shollën e Lartë të detarisë në Riga të Letonisë. Në Riga zhvilluan gjashtë muaj program mësimor dhe më tej i transferojnë në Shkollën e Lartë të Nënuesjes në qytetin e Leningradit, ku edhe filluan studimet në vitin e dytë. Në përfundim të këtij vitit mësimor në korrik 1960 shkuan për një muaj praktikë mësimore në Brigadën e Nëndetëseve. Pas praktikës u kthyen sërish në shkollë. Në pranverën e vitit 1961 përfunduan procesin mësimor, duke dhënë edhe provimet e vitit të tretë. Është fakt se studentët shqiptarë të marinës në këtë periudhë i kryenin studimet në qytetet bregdetare si në Leningrad (Rusi),



Baku (Azerbajxhan) Odesa (Ukrainë), Riga (Letoni), por largimi i studentëve shqiptarë nga ish-BS-ja ishte përgjigjja flakë për flakë veprimeve arrogante e agresive të rusëve në Pashaliman, të cilët edhe tentuan të rrëmbenin, apo dhe të sabotonin teknikën e nëndetëseve, ku nga 12 nëndetëse që ishin aty katër u ngelën shqiptarëve. Por në vitin 1961 me prishjen e marrëdhënieve me ish-Bashkimin Sovjetik u kthyen në Atdhe dhe ashtu siç u premtoi Atasheu Ushtarak në Moskë, Halim Ramohito, ishin marrë të gjitha masat që mësimet do t’i vijonin në Shqipëri atje ku i kishin lënë. Rifillimin e studimeve e konfirmoi dhe i dërguari i posaçëm, ushtaraku i lartë shqiptar Gjeneral Dilaver Poçi, pasi Gjeneral Halim Ramohito ishte shpallur “non grata” nga Rusët. Në Shtator 1961 u çel Shkolla e Lartë e Detarisë fillimisht në Pashaliman, ku filluan mësimin tre kurse. Kursi ku bënte pjesë Tasim Meçe filloi mësimin në vitin e katërt. Pas një viti studimesh në Pashaliman, më 1 korrik 1962, emërohen oficerë të FLD-së. Në provimet e diplomimit, kryetar i komisionit ishte Komandanti i FLD-së Admiral Abdi Mati. Kuadrot që mbaruan shkollën shkëlqyeshëm u graduan togerë, ndërsa të tjerët nëntogerë. Tasim Meçe merr për herë të parë gradën ushtarake toger, për përfundim shkëlqyeshëm të shkollës si dhe e emërojnë navigator në Nëndetëse. Ndërkohë që vendi ku duhej të ndërtohej Akademia e Marinës shqiptare ishte planifikuar të ngrihej që në kohën e Rilindjes Shqiptare: “Shkolla e anijerisë duhet të jetë mbanë detit, tek të jenë edhe anijet e luftës, në Durrës a në Ujt’ të Ftohtë, ndanë Vlorës”. (Sami Frashëri/Shemsedin Sami, “Shqipëria çka qenë ç’është e çdo të bënetë”). Akademia e Marinës u ngrit më 4.9.1961, në një kohë të “infarktit historik” dhe u shkri nga “infarkti politik”. Viti 1962 ishte viti i fillimit të karrierës ushtarake. Më tej në vijimësi ka kryer edhe detyrën e zëvendëskomandantit të Nëndetësës, ndërsa në vitin 1969 emërohet Komandant i Nëndetësës (N/D-4). Që prej vitit 1967 ishin hequr gradat dhe për gati 24 vjet ka shërbyer në Forcat Luftarake Detare (FLD) pa grada. Në vitin 1974 emërohet

Shef i Shtabit të Brigadës së Nëndetëseve, ndërsa në vitin 1975 emërohet Komandant i Bazës Ushtarake Detare (BUD) në Vlorë. Në fund të vitit 1975, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes, u krijua Grupimi Operativ i Mbrojtjes të Ishullit të Sazanit, me komandant Grupimi Neim Muhon dhe komisar Ibrahim Gaxholli; në këtë rast caktohet me detyrën e zëvendëskomandantit për Flotën. Në përbërje të grupimit ishin Brigada e Këmbësorisë së Ishullit, Regjimenti i ABD-së, Artileria Tokësore, bateritë e AKA-së, repartet e BUD-it të dislokuar në Sazan me emërtim të ri, Regjimenti i anijeve dhe anekset përkatëse të prapavijës (logjistikës). Në vartësi të grupimit ishin, të gjitha objektet social-kulturore, ekonomia ndihmëse, rrobaqepësia, Shkolla 8-vjeçare “22 Tetori”, kopshti, çerdhja për fëmijët e ushtarakëve. Në shtator 1976 deri në korrik 1978 vijoi studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë, për “shtabnik”, të cilën e përfundoi me rezultate shumë të mira dhe pas saj emërohet Komandant i Grupimit Operativ I Sazan, detyrë që e ka kryer deri në vitin 1983. Ishte pikërisht kjo periudhë kur Tasim Meçe ishte autoriteti më i lartë i ishullit të Sazanit nga ku komandonte tërë rrjetin e vëzhgimit detar dhe nuk lejonte jo vetëm shkeljet detare por as kontrabandën e mundshme që edhe në Shqipëri nuk mungonte, por me “bekimin” e shtetit. Në vitin 1983 grupimi u shpërbë dhe Tasim Meçe kaloi përsëri Komandant i BUD-it në Vlorë, detyrë që e ka kryer deri në vitin 1988. Në vitin 1988 deri fund të vitit 1990 ka kryer detyrën e Shefit Operativ në Shtabin e FLD-së. (Emërimi në këtë detyrë të lartë është bërë me vendim të Sekretariatit të Komitetit Qendror nr.79 datë 20.7.1987). Sikurse gjithë armët dhe shërbimet edhe Marina kishte shkollën e saj. Shkolla shqiptare e detarisë përgatitës kuadro për marinën luftarake, për marinën tregtare dhe për marinën e peshkimit. Kuadrot e shkollës së Marinës drejtonin edhe anijet e flotës tregtare që çanin oqeanet dhe bënin lundrime të gjata prej Paqësorit, në Atlantik, në Oqean e në detin e Veriut, madje dhe në Amerikën Latine, në Kinë përgjatë



shumë vendeve afrikane në Poloni e deri në Holandë edhe me anije 12-15 mijë tonësh, duke lëvruar mallra në shumë vende të botës. Që në fakt marina jonë kishte filluar që më 25.12.1925 me dy anije 190 tonësh, të ardhura nga Italia, të cilat mbanin emrat sinjifikativë “Shqipëria” dhe “Skënderbeg” dhe që kryen vetëm detyra policie/roje bregdetare kundër kontrabandës. Në gjysmëshekullin e kaluar ne kishim 42 katera-silurues vetëm me një mision: të goditnin me 84 silurë, sikurse dhe me katër, nëndetëset tona mund të jepnim goditje të befasishme dhe në det të hapur me nga 12 silurë secila. Pra në total vetëm me një mision do të lëshonim nga anijet tona luftarake gati 130 silurë. Fakt është gjithashtu se italianët, grekët e jugosllavët e njihnin fuqinë e flotës tonë të njohur dhe në arenën ndërkombëtare. Dalja nga “Traktati i Varshavës” për marinarët dhe oficerët tanë dhanë një shembull të shkëlqyer me kryerjen e detyrave të zbulimit sikurse bëri një nga nëndetëset tona më 1957-n, e cila doli në Mesdhe dhe që luftanijet dhe avionët e NATO-s u alarmuan, sepse në rajonin ku bënte zbulim ajo, ndodhej në një anije luftarake të NATO-s vetë Presidenti Amerikan, Ajzenahuer, që dikur, gjatë LIIB, kish qenë edhe kryekomandant i forcave aleate në Evropë. Tasim Meçe, duke folur për shërbimin në ishullin e Sazanit shprehet: “Nuk mund të harroj kurrë Sazanin. Si mund të harroj?! 20 vjetori më gjeti në Pashaliman, 40 vjetorin e festova në Sazan, nga këto 13 vjet në nëndetëse. Gjithë rininë time, si dhe shumë shokë të tjerë e sakrifikuam duke punuar e shërbyer në kushte e vende të vështira, jo vetëm ne, por dhe familjet tona. Një gjë nuk e harrojmë kurrë shoqërinë e mrekullueshme që patëm, në Pashaliman, ashtu dhe në Sazan. Ajo na mbajti gjallë, dhe e ruajmë si gjënë më të shtrenjtë, edhe sot e kësaj dite...”. Nga historia jetësore e FLD-së, ndër të tjera Komandant Tasim Meçe tregon edhe për atë që ndodhte në të vërtetë në përballje me ruajtjen e hapësirës detare shqiptare. Kjo vërtetohet katërçipërisht me përgjegjësinë e madhe për kryerjen e detyrës, në çdo lloj kushti e situatë.

Në piramidën e drejtimit të FLD-së së Shqipërisë
Ndërsa në vitin 1991 - 1992 ka kryer detyrën e Komandantit të FLD-së (18.3.1991 deri 20.7.1992 del në Rezervë sipas VKM nr.225 dt.29.5.1992), një detyrë me mjaft përgjegjësi kjo që ishte edhe maja e piramidës së detyrave që mund të kryejë një oficer i Flotës Luftarake Detare. Detyra kryesore gjatë këtyre viteve ishte sigurimi i anijeve dhe vendbazimeve nga rrëmbimet dhe grabitjet e mundshme, pasi ishte një periudhë tranzitore e kalimit nga socializmi në demokraci, periudhë mjaft komplekse që në fakt arriti kulmin në vitin e mbrapshtë 1997, me shkatërrimin e të gjithë ushtrisë, uzinave e fabrikave nën moton e çekut të bardhë se çdo gjë duhet ta fillonim nga e para. Disa nga përparësitë e arritjeve gjatë periudhës së drejtimit të oficerit madhor Tasim Meçe gjatë viteve 1991-1992, vlen të përmenden ato që kanë të bëjnë me vizitën në vend dislokimin

e Operacionit “Pelikan” me ministrin e Mbrojtjes, Perikli Teta, për të organizuar sigurimin e transportit e ndihmave, jo vetëm nga toka, por edhe nga deti me anijet tona dhe ato të Grupit Naval Italian, në përbërje të 6 motovedetave të dislokuara, tre në Durrës e tre në Vlorë; përcaktimi i detyrave konkrete të grupeve navale; kalimi i Kapitanerive të porteve nga Ministria e Transporteve në vartësi të Komandës së FLD-së ishte një tjetër detyrë kryesore, për kontrollin e pritjes së anijeve në porte, e daljes së tyre në det; riorganizimi i kapitanerive të porteve dhe kompletimi i tyre me kuadro dhe dokumentacionin e rregulloret përkatëse të shërbimit; pritje të ndryshme me Atashetë e vendeve mike: amerikanë, italianë e turq. Pritja e delegacionit të parë ka qenë ajo e kapitenit të kapitanerive të porteve italiane, më 26.8.1991, në Bashkinë Durrës, me kryetar Bashkim Koplikun. Pritje dhe vizitë në kryqëzorin italian “Andra Doria” në Durrës me ministrin e Mbrojtjes Safet Zhulali, pritja në BUD-in e Shëngjinit e Shefit të Shtabit të Ushtrisë Turke gjeneral Dogan Gyresh, i cili vlerësoi shumë strehimin e të gjitha anijeve, depot e rezervave materiale, oficinës të riparimit, Komandën dhe shtabin e Bazës, brenda në tunelin kundëratomik. Dogan Guresh, kur hyri brenda në tunel në bazën e Shëngjinit më 1992, deklaroi: “Këtë mrekulli që kam parë në Shëngjin, nuk e kam parë në asnjë vend të botës, as në Japoni dhe as në Suedi”. Me ftesë të Shefit të Shtabit të Ushtrisë Turke, edhe ne shkuaam për vizitë në Turqi, ku delegacionin e kryesonte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Kostaq Karoli, ku në përbërje të këtij delegacioni ishin: Komandanti i Aviacionit Klement Aliko, Komandanti i FLD-së Tasim Meçe, Drejtori i Xhenios, Ndërlidhjes dhe i Prapavijës. Delegacioni shqiptar vizitën e parë e bëmë në selinë e Shtabit të Përgjithshëm dhe në darkën që shtroi Gjenerali me katër yje Dogan Gyresh, për nder të delegacionit tonë, na ftoi për vizitë edhe në shtëpinë e tij. Gjatë vizitës në Turqi u takuam edhe me Presidentin e Republikës së Turqisë Sulejman Demirel. Ndërkohë që sipas drejtimeve delegacioni ynë takoi dhe bisedoi me homologët respektivë të komandave të forcave turke. Kështu u realizua edhe një vizitë e veçantë edhe me Komandantin e Flotës Luftarake Turke me Admiral Irfan. Ndërkohë që vizitën tjetër e realizuan në Bazën Detare të Golçukut, më e madhja në Turqi, ku delegacioni shqiptar u prit nga Komandanti i Bazës Admirali Vural Bajazit. Delegacioni shqiptar parashtroi edhe një kërkesë për mbështetje me ndihma materiale shumë të domosdoshme për nevojat e FLD-së shqiptare, ku pala turke e mirëpriti dhe me dashamirësi iu përgjigj pozitivisht të gjitha kërkesave shqiptare, materiale që i sollën me një anije ushtarake në Shqipëri. Gjatë vizitës si komandant flote, por dhe delegacioni që e shoqëronte pa nga afër kantierin e ndërtimit dhe riparimit të anijeve, dhe një nëndetëse. Në nëndetëse u zhvillua edhe një stërvitje, ku supozohej një nëndetëse e mbytur dhe efektiv i do dilte në sipërfaqen e ujit me pajisje palombari. Një

stërvitje të tillë shqiptarët e kishin parë 30 vjet më parë në Shkollën e Marinës në Leningrad, gjatë vitit të tretë mësimor. Gjatë kësaj vizite delegacioni shqiptar u njoh nga afër me Shkollën e lartë të Detarisë në Golçuk, muzeun e Flotës Luftarake Detare Turke, Uzinën e ndërtimit të avionëve supersonik, xhaminë Blu dhe mjaft muzeume e qendra muzeale të Turqisë. Në Shtator të vitit 1992 në kulmin e karrierës Tasim Meçe e nxjerrin në lirim me reformë, kur vishte në moshën 49 vjeçare, me një asistencë dy vjeçare prej 2400 lekë në muaj. Nxjerrja në lirim ishte ndërprerje e karrierës ushtarake të detyruar nga politika. Përgjatë karrierës ushtarake Tasim Meçe është vlerësuar me disa medalje e dekorata sikurse janë: Urdhri i shërbimit ushtarak i klasit të tretë (1969); Urdhri për trimëri civile (1981); Medalje “Nderi i ushtarakut”, Medalja e Mirënjohjes” (1974). Urdhri i Yllit të Kuq klasi tretë (24.3.1990). Fakt është se Tasim Meçe ka qenë nën uniformë në shërbim të vendit nga momenti kur u rreshtua si kursant në shkollën “Skënderbej”, më 1.9.1954 deri më 20.7.1992, pra 38 vite nën uniformë. Bazuar në dosjen personale që gjendet në QPR gradën toger e ka marrë, më 1 gusht 1962, me urdhër nr. 1798, datë 31.7.1962; ndërsa gradën “kapiten lejtnant” e ka marrë, më 1 gusht 1965, me urdhër nr. 0378 datë 11.9.1965; ndërsa grada ushtarake Kapiten i Rangut të parë është vendosur më datën 28.11.1991”.

Cilët kanë drejtuar FLD-në në Shqipëri?
Shqipëria, duke qenë në një pozicion të favorshëm gjeostrategjik e ka pasur, e ka dhe do ta ketë të nevojshme mbrojtjen dhe sigurinë edhe nga drejtimi detar. Për këtë në 112 vite të ekzistencës së shtetit shqiptar janë marrë masa për mbrojtje detare, ose është menduar rreth saj nga lidershipi politik dhe ushtarak, por mbrojtja e hapësirës detare kërkon resurse të mëdha për ta bërë plotësisht të garantuar sigurinë shqiptare. Për këtë nuk mjaftojnë planet, programet, doktrinat e strategjitë, ligjet e vendimet e pambështetura realisht me mjete e forca detare. Por është gjithashtu fakt se mbrojtja detare solide vendi ynë ka pasur në gjysmëshekullin e shkuar. Por kush e ka drejtuar lidershpin ushtarak shqiptar në drejtimin detar. Nga viti 1928 e deri më sot vendi në drejtimin e mbrojtjes dhe sigurisë detare është udhëhequr nga njëzet komandantë të forcave detare që kanë qenë sipas viteve të drejtimit: Kapidan Ahmet Kapidani (1928 - 1939); Kundëradmiral Abdi Mati (1945 - 1957, shtator 1961 - shtator 1973); Kundëradmiral Teme Seiko (1958 - gusht 1960); Kundëradmiral Hito Çako (shtator 1960 - shtator 1961); Pa gradë Qamil Poda (shtator 1973 - korrik 1981); Pa gradë Ndue Jaku (1981 - 1991); Kapiten i Rangut I Tasim Meçe (28.11.1991 – shtator 1992); Kapiten i Rangut I Fitim Halili (1992 - 1993); Kundëradmiral Edmond Zhupani (1993 - 1994, 1996 - 1997); Kundëradmiral Muharrem Kuçana (1994 - 1996); Kapiten i Rangut I Vladimir Beja (mars - shtator 1997); Kapiten i Rangut I Robert Bali (shtator 1997 - tetor 1998); Kundëradmiral Kudret Çela (nëntor 1998 - mars 2005); Kapiten i Rangut I Kristaq Gërveni (mars 2005 - shtator 2009); Kundëradmiral Kudret Çela (shtator 2009 - janar 2012); Kapiten i Rangut I Ferdinand Kreshpani (janar 2012-gusht 2012).

Në vijimësi për dhjetë vite drejtuesit e Forcave detare nuk kanë qenë detarë, por një zgjidhje e lidershipit politik e ushtarak të vendit, ndërkohë që forcave detare iu është rikthyer legjitimiteti vetëm pas dhjetë vitesh, më 2022, me emërimin në detyrën e drejtuesit të forcës detare një detar të mirëfilltë. Në vijimësi forcat detare janë drejtuar nga Gjeneral brigade Qemal Shkurti (15 gusht 2012 - maj 2015); Gjeneralmajor Ylber Dogjani (16 tetor 2015 - 16 shtator 2019); Gjeneral brigade Ilir Xheboxhja (tetor 2020-janar 2022); Kundëradmiral Adnand Agastra nga janari 2022 e në vijim.

Duhet pranuar se Komandantëve që kanë drejtuar anije luftarake të periudhës gjysmëshekullore ka në vijimësi se çfarë të tregojnë në aspektin teorik dhe praktik të mbrojtjes së hapësirës detare, pasi ata e njohin detin më mirë se tokën. Prandaj edhe meritojnë nderimin dhe respektimin e të gjithë brezave të detarëve, pasi vlerësimi për ta është vlerësim për mbrojtjen e vendit dhe hapësirës së shenjtë detare. Detarët dhe jo vetëm gjithë ata që i shërbyen dhe i shërbejnë Atdheut denjësisht me zemër e shpirt meritojnë nderimin ushtarak dhe qytetar, të vendlindjes dhe të kombit. Nuk është e rastit që shumë bashki në vendin tonë kanë nderuar njerëz me kontribute të shumta për vendin për sigurinë dhe mbrojtjen dhe një nga këta është padyshim edhe Tasim Meçe, që i ka qëndruar stoik idealeve të tij të mbrojtjes së vendit dhe zhvillimit e përparimit të tij. Forcat luftarake detare ku shërbeu Tasim Meçe gjatë Luftës së Ftohtë, Forcat e Armatosura numerikisht arritën 61000 forca aktive, dhe 380.000 forca rezerviste e vullnetare; të cilat u riorganizuan disa herë. Efektiv i FLD-së arriti në rreth 5000 vetë me një potencial mjetesh detare luftarake të konsiderueshme, por mbi të gjitha plotësisht të afta për kryerjen e misionit. Tasim Meçe është konkret kur shprehet se: “Në vitin 1945 Shqipëria e filloi nga “hiçi” dhe të mendosh se në fund të viteve 90’-të të shekullit të kaluar kishim gati 150 anije luftarake dhe ndihmuese me dy destinacione kryesore, atë të kohës së paqes dhe të kohës së luftës. Në kohë paqeje, ne siguronim paprekshmërinë e Atdheut dhe ruajtjen e ujërave tona territoriale, ndërsa në kohë lufte, Flota kryente detyra të shkallës operative që do të thoshte me anijet tona luftarake në situata kërcënuese, por edhe në luftë, pengonim karvanët e anijeve armike në bashkëpunim të ngushtë me aviacionin tonë dhe artilerinë bregdetare, duke dhënë goditje me silurë si nga katerat silurues ashtu dhe nëndetëset tona për të prishur dhe penguar formacionet e armikut. Kjo pengesë do t’i jepte kohë popullit që të armatosej dhe të ish i gatshëm për të përballuar agresionin. Në raport me shtrirjen tonë gjeografike, sasinë e popullatës dhe hapësirën detare ne kishim flotë të fuqishme, një popull me 3,5 milionë banorë kishte 150 anije, duke u krahasuar me Italinë, Greqinë e Jugosllavinë përllogaritur për numër popullsie, ne shqiptarët ishim tërësisht të mirë për gatitur dhe mirë organizuar në përballimin e të gjitha situatave në tokë, në det dhe në ajër”.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Umbyll dhe një vit mes sfidash dhe emocionesh, mes gëzimesh dhe hidhërimesh, mes ëndrrash dhe realitetesh. Kjo është jeta jonë në 365 ditët e një viti dhe këta jemi ne ‘investitorët strategjikë’ të saj. Ne, humanët që zhvillojmë dhe shkatërrojmë me duart tona gjithçka të ndërtuar me kujdes qysh prej transformimit homosapiens.

Por për çfarë do mbahet mend ky shekull?!

Shekulli XXI, do të mbahet mend gjatë në historinë e njerëzimit, për shkak të dinamikave që ky shekull prodhoi, si revolucion i teknologjik, inteligjenca artificiale, inteligjenca bioteknologjike, sollën të këqijat në këtë shekull bashkë me të mirat e pafundme të tij.

Terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm, është një ndër sfidat më të mëdha të këtij shekulli, i cili ka goditur fort zemrën e botës. Kemi parë për vite me radhë sesi terrorizmi godet qendrat e civilizimit, ato që janë menduar të pathyeshme, nga Uashingtoni në Nju Jork, në Bruksel, Berlin, Paris e Londër.

Fake News, ose industria e lajmeve të rreme, ka qenë një problem më shumë i dekadës së fundit. Fake News, e tregoi se forca e tij mund të çorodiste botën, mund të shkaktonte kaos dhe keqkuptime të mëdha, dhe në këtë aspekt qeveritë e botës, dhe mediat më prestigjioze investuan përsëri miliona dollarë për këtë fenomen shkatërrues. Jo pak problem për njerëzimin është dhe fenomeni i ngrohjes globale në këtë shekull u kthye në kryefjalë të ruajtjes së njerëzimit, çorientimi i temperaturave, dhe rritja e ndotjes globale, shqetësoi pa masë shkencëtarët, të cilët disa herë dhanë alarmin për fundin e dhimbshëm të planetit tonë, Tokës, e që rrezikohej pikërisht nga faktori human, nga njeriu që shfrytëzon pa kriter burimet natyrore.

Fuqitë e tyre, shtetet e mëdha i matën me zhvillimin e armëve bërthamore, të cilat e çuan botën disa herë në pikën fundore të një përplasje të ashpër superfuqish. Kriza e demokracisë dhe përplasja e civilizimeve ka qenë një tjetër debat i ashpër në këtë shekull.

Perëndimi, Kina apo Islami?

Yuval Noah Harari në librin e tij “21 leksione për shekullin XXI”, shkruan ndër të tjera se “Njerëzimi po humbet besimin tek ideologjia liberale, e cila ka dominuar politikën botërore gjatë dekadave të fundit, pikërisht në kohën kur shkrija mes bioteknologjisë dhe teknologjisë së informacionit po na vë përballë sfidave më të mëdha që ka njohur ndonjëherë njerëzimi”.

Por, në këtë kohë të gjithë po kuptojmë diçka që shumë nuk e pranojnë, dhe kjo nga fanatizmi që paskan investuar gabimisht në prodhime të pamasa armësh biologjike e bërthamore.

Bota ka investuar miliarda dollarë në ushtri e armë, në zotërim informacioni, në të dhënat personale të njerëzimit, ka investuar miliarda e miliarda duke ngritur mure për njerëzit, por sot në vitin 2025 e tërë bota po sheh shembjen e sistemeve shëndetësore para tyre.

Ndikimi i teknologjisë ka ndryshuar rrënjësisht jetën tonë, shoqëria brenda këtij 10-vjeçari është gjatë gjithë kohës në lëvizje, të gjithë janë me nxitim, të gjithë nguten, jo rrallë dëgjojmë shprehjen: “Nuk kam kohë”, “Tani nuk mundem”, E kam me nxitim”...

Ne flasim më shkurt dhe më pak në komunikimin tonë të përditshëm. Mesazhet që u dërgojmë miqve tanë me telefon apo e-mail janë të shkurtra dhe siguri që presim prej tyre një përgjigje të shpejtë, e cila nëse vonon më shumë se 10 minuta atëherë kjo fillon të na shqetësojë.

